



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 364 Prot.

Tiranë, më datë 18 . 09 .2019

**VENDIM**

**Nr. 302, datë 18.09.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RESTAURIMIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, pas shqyrtimit më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.09.2019,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Projektit: “Restaurimi i Urës së Gurit Qukës”, Librazhd, hartuar nga specialistët e IMK-së;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

Arta Dollani

**KRYETAR**

**Ejva MARGARITI**

